




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo




AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK
Nr. Prot. 01-992/15
Prot No. 01-992/15
Data 02-04-2015
Datum 02-04-2015
PRISHTINË

DATE/A:	01.04.2015
REFERENC-Ë:	DPK-DPKPP 03-03/953/15
PËR/ZA/TO:	z. Gazmend RUSHITI Shef i Prokurimit në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës
CC:	z. Curr GJOCAJ Drejtor i Përgjithshëm në SHSKUK
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me monitor të pacientit "



I nderuari z. Rushiti ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin " Furnizim me monitor të pacientit " me numër prokurimi 701-15-053-131, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull " Furnizim me monitor të pacientit " me numër prokurimi 701-15-053-131, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsy etimi

Zyra e Prokurimit, pranë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës ka iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull "*Furnizim me monitor të pacientit*" me numër prokurimi 701-15-053-131, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 27.03.2015. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e Kuotimit të çmimit, kontratë të llojit Furnizim me vlerë të vogël të kontratës, ku ka paraparë Furnizimin me 6 monitor për pacient me pesë parametra.

Agjencia kundër Korrupsionit, përmes Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa kërkesa që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit tek rubrika III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 4, Autoriteti kontraktues ka kërkuar që produktet e ofruara duhet të jenë të prodhuara në shtetet e BE-së, (*vendet e zones shengen*) zvicër, SHBA, Australi, Kanada, Turqi, Izrael, Japoni dhe Britani e madhe, kërkesë për të cilën Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se bie ndesh me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues me formulimin e kësaj kërkesë ka përcaktuar vendin e origjinës e këtyre pajisjeve duke bërë kufizimin në disa shtete të caktuara. Me përcaktimin e vendit të origjinës për pajisjet furnizuese, mund të favorizohen Prodhues apo Operator të caktuar Ekonomik dhe në të njëjtën kohë diskriminohen të tjerët. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që pajisja të jetë e kualitetit të lartë apo ti referohet një standardi vendor, europian ose ndërkombëtar për furnizim me këto pajisje. Mirëpo assesit nuk lejohet të kërkojë nga ndonjë vend i caktuar. Bazuar në Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik theksohet shprehimisht se " **Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik** ".

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !